

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Shërbim i lavanderisë dhe furnizim me materiale të buta të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor  
Korçë**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):**

Shërbime për furnizimin e lavanderisë së spitalit- 85112100-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 166,268,448 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzet e tetë ) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentim:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike. Garancia mbi përvojën e ngjashme është e rëndësishme, duke mbajtur në konsideratë natyrën e objektit e prokurimit, që lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin e pacientëve në spital.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në rastin kur është në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar.

Operatorët që nuk kanë detyrim për tu pajisur me këtë leje, duhet të paraqesin deklaratë/dokumentacion që vërteton kapacitetin maksimal ditor të aktivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 5, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë lejen mjedisore që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Pajisja me këtë leje mjedisore, siguron AK që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim kërkesave ligjore mjedisore, si dhe shërben si garanci që ekzekutimi i marrëveshjes kuadër, do të kryhet nga OE në përputhje me standartet e kërkuara ligjore dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.** Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është lavanderia, vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient për kryerjen e këtij shërbimi dhe të gjitha proceseve të punës, që ky shërbim përfshin, si: larje, tharje, hekurosje, paketim. Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, i cili plotëson kushtet higjeno-sanitare, siguron AK që shërbimi i lavanderisë, objekt prokurimi, do të kryhet në kohë, cilësi dhe konform kushteve higjeno-sanitare.

Pajisja me aktin higjeno-sanitar e këtij ambjenti, është vendosur bazuar në Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 139, datë 14.4.2011, “Për lëshimin e akt miratimit higjeno-sanitar”, Udhëzimin nr.510, datë 13.12.2011, “Për inspektimet higjeno-

sanitare në funksion të lëshimit të akt miratimit higjeno-sanitar, si dhe duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka ruajtja dhe plotësimi i kushteve të higjenes, për këtë shërbim, i cili lidhet drejtpërdrejt me shëndetin e pacientëve në spital.

2.3.4 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 8 (tetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| NR. | Stafi                            | Nr.             |
|-----|----------------------------------|-----------------|
| 1   | Përgjegjës Shërbimi              | 1 (një)         |
| 2   | Punëtore në Lavanderi            | 5 (pesë)        |
| 3   | Shofer/Punëtor ngarkim shkarkimi | 2 (dy)          |
|     | <b>Totali i punonjësve</b>       | <b>8 (tetë)</b> |

Për punonjësit në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

*Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshin shërbimi i lavanderisë, si më poshtë: Përgjegjësi i shërbimit ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të lavanderisë, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur përgjegjësi për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara.

Disponimi i punëtorëve në lavanderi siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset e larjes, tharjes, hekurosjes, paketimit, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Shofer/Punëtor ngarkim shkarkimi ndihmojnë në transportimin e materialeve të buta të kërkuara për furnizim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

| Nr | Emërtimi                                                                                                                                                             | Njësia | Sasia minimale e kërkuar |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|--------------------------|
| 1  | Makineri larese profesionale për një kapacitet lare prej 270kg/dite                                                                                                  | cope   | 2                        |
| 2  | Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale për një kapacitet hekurosje minimalisht prej 270 kg/dite.                                                                     | Cope   | 2                        |
| 3  | Makineri tharese profesionale me kapacitet mbi 20 kg secila                                                                                                          |        | 2                        |
| 4  | Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash, për një kapacitet paketimi minimalisht prej 270 kg/dite.                                                         | Cope   | 1                        |
| 5  | Karroca metalike transportuese për materialin e bute, ne pavione. (Materiali i lare dhe i paketuar)                                                                  | Cope   | 10                       |
| 6  | Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet të jetë e kalibruar dhe të shoqëruar me akt kolaudimi nga autoritete përkatëse (Drejtoria e përgjithshme e Metrologjisë) | Cope   | 1                        |
| 7  | Hekur profesional me avull për të hekurosuar uniformat                                                                                                               | cope   | 1                        |

|    |                                                                                                                                                            |      |    |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|----|
| 8  | Karroca sherbimi profesionale per ne pavione me rrota (me ndarje me kapak te paisur me thase me ngjyra per vendosjen e materialit te papaster)             | cope | 10 |
| 9  | Canta ( Thase) per transport material i bute sipas ngjyres se ndarjes se materjalit te papaster.                                                           | cope | 50 |
| 10 | Kosha metalike /plastike/karela per mbajtje material I bute Brenda ambjenteve te lavanterise, me kapacitete te ndryshme per te perballuar volumin e punes. | cope | 10 |

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të lavanderisë dhe të gjitha proceseve të tij, si: larje, tharje, hekurosje, ndarja- marrja e materialeve të buta sipas ndotjes dhe shtrimin e tyre.

Duke qenë se njësia matëse e objektit të prokurimit, është kg, dhe OE do të ofertojnë për njësinë në kg, disponimi i peshores, lidhet drejtëpërdrejtë me ekzekutimin me sukses të kontratës.

Disponimi i këtyre mjeteve (lloji, sasia dhe pesha) është vendosur bazuar në proceset e punës të shërbimit objekt prokurimit, si dhe sasisë së parashikuar nga AK të materialeve që do të lahen, duke shërbyer si garanci e AK që shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet me cilësi dhe konform të gjitha kërkesave të AK.

#### Analizë gjithëpërfshirëse për vendosjen e makineri paisjeve

##### 1. Pajisjet e larjes dhe barrierat

- Makineri Larëse: E domosdoshme për kryerjen e procesit të larjes.

##### 2. Pajisjet e specializuara për materiale të ndjeshme

- Makina tharëse profesionale : Tharja e shpejtë dhe e plotë është kritike për të shmangur rritjen e mykut dhe bakterieve.

##### 3. Logjistika e brendshme

- Karrela dhe Kosha për grumbullimin dhe transportimin e materialit te bute te palare: Sigurojnë lëvizjen e sigurt dhe të organizuar të rrobave brenda lavanderisë, duke ndarë materialet e pastra nga ato të ndotura.
- Karroca Sherbimi per nderrimin ne pavione te materialit te bute tek shtrati i pacientit: Ndhimjnë personelin të mbledhë rrobat sipas kategorive (infektive, jo-infektive, të bardha, të ngjyrosura).

#### 4. Pajisjet e përpunimit final

- Makineri Hekurosese (Rul) Profesionale: Sigurojnë uniforma dhe çarçafë të rrafshët, pa rudha, duke përmirësuar prezantimin dhe higjienën.
- Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash: Paketimi i inventarit të butë (çarçafë, uniforma) mbron nga ri-kontaminimi gjatë transportit.

Peshore elektronike mbi 100 kg (1 copë): Sigurojnë matje të sakta duke optimizuar ciklet e larjes dhe duke respektuar standardet metrologjike.

Kapaciteti i peshores elektronike është përcaktuar i tillë duke marrë në konsideratë mënyrën operative të grumbullimit dhe transportit të tekstileve në shërbimin e lavanderisë. Tërheqja e materialeve të ndotura realizohet nëpërmjet thasëve të veçantë me ngjyrë, sipas ndotjes, në përputhje me protokolloet higjieno sanitare për kategorizimin e tekstileve. Përdorimi i peshoreve me kapacitet më të ulët do të kërkonte hapjen dhe ndarjen e thasëve, duke rritur kështu kohën e përpunimit dhe rrezikun higjieno sanitar.

Në thelb, ky set pajisjesh nuk përbën një kërkesë të panevojshme e të tepërt, por minimumin e domosdoshëm për të garantuar që lavanderia e spitalit funksionon si një strukturë kritike e kontrollit të infeksioneve.

Duke pasur parasysh volumin e punës: 393,600 kg materiale për t'u larë në lavanderi gjatë 48 muajve.

#### Përlllogaritja e ngarkesës

- Totali: 393,600 kg
- Periudha: 48 muaj
- Mesatarja ditore (sipas specifikimeve teknike):  $\approx 270$  kg në ditë

Volumi prej 393,600 kg në 48 muaj është i madh dhe kërkon një infrastrukturë lavanderie të plotë, me pajisje të specializuara dhe logjistikë të mirëorganizuar. Çdo pajisje e listuar është pjesë e një zinxhiri funksional që siguron:

- Higjienë maksimale
- Efikasitet operacional
- Siguri për pacientët dhe stafin
- Përmbushje të standardeve ligjore dhe metrologjike

2.3.6 Operatori ekonomik në lidhje me materialin e butë të përcaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme, e cila do të shërbejë gjatë zbatimit të kontartes:

| Nr | Emërtimi                 | Prodhuesi |
|----|--------------------------|-----------|
| 1  | Çarçaf shtrati I poshtem |           |
| 2  | Çarçaf shtrati i sipërm  |           |
| 3  | Çarçaf pediatrik         |           |
| 4  | Carcafe zarf             |           |

|    |                                                    |  |
|----|----------------------------------------------------|--|
| 5  | Carcaf Zarf<br>pediatrik                           |  |
| 6  | Këllef jasteku                                     |  |
| 7  | Peshqir pacienti                                   |  |
| 8  | Këllef dysheku<br>i gomuar                         |  |
| 9  | Këllef dysheku<br>per pediatrie                    |  |
| 10 | Dyshekë tek<br>spitalor                            |  |
| 11 | Dyshekë për<br>pediatrinë                          |  |
| 12 | Pandofla<br>pacienti                               |  |
| 13 | Pizhame fëmije                                     |  |
| 14 | Pizhame<br>pacienti burri                          |  |
| 15 | Bizhame<br>pacienti grash                          |  |
| 16 | kemisha grash<br>trikotazh                         |  |
| 17 | Piceta<br>pediatrike                               |  |
| 18 | Piceta f grash                                     |  |
| 19 | Jastëkë                                            |  |
| 20 | Kompresa<br>kirurgjike me<br>vrime                 |  |
| 21 | Batanije<br>180x140                                |  |
| 22 | Batanije<br>pediatrike<br>150x110                  |  |
| 23 | Batanije<br>neonati                                |  |
| 24 | Komplete<br>operacioni të<br>sallës                |  |
| 25 | Kostume<br>infirmieri                              |  |
| 26 | Kostume<br>infirmieri +<br>mjek urgjence<br>+salla |  |
| 27 | Kostume<br>Infirmierë +<br>Mjek<br>reanimacioni    |  |
| 28 | Kostume<br>Infirmier<br>pediatri                   |  |

|    |                                          |  |
|----|------------------------------------------|--|
| 29 | Kostum<br>Infermier<br>pediatri          |  |
| 30 | Kostum Teknik<br>laboratori              |  |
| 31 | Kostum Teknik<br>imazheri                |  |
| 32 | Kostum<br>sanitari                       |  |
| 33 | Kostume<br>personeli<br>ndihmes          |  |
| 34 | Kostume<br>infermjeri<br>maternitet      |  |
| 35 | Perparese<br>mjeku                       |  |
| 36 | Jorgan me<br>vatine 180x140              |  |
| 37 | Jorgan me<br>vatine pediatrik<br>130x100 |  |

**Shenim: ne fazen e ofertimit do te vleresohet plotesimi i tabelës sipas formatit.**

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke vlerësuar proceset e shërbimit, objekt prokurimi, dhe detyrimet e ofertuesit i cili do të shpallet fitues për të siguruar inventarin e materialit të butë, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka Spitali Korçë, me emërtimin dhe siglën përkatëse të saj, për secilin artikull të përmendur, kriteri i mësipërm garanton AK për realizimin e kontratës/ava, konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë për produktet larese që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës:

| Materialet e pastrimit |                                     |           |                               | Spitali Korçë                                                                                                                                                  |
|------------------------|-------------------------------------|-----------|-------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nr.                    | Emërtimi i produktit që do të lahët | Prodhuesi | Lloji/Emertimi I detergjentit | <b>Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar</b><br><i>*ky seksion plotësohet<br/>ce/deklarate konformiteti ose NA<br/>(nuk aplikohet)</i> |
| 1                      | Material i kontaminuar              |           |                               |                                                                                                                                                                |

|   |                                                                                |  |  |  |
|---|--------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
| 2 | Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjekesinë nukleare |  |  |  |
| 3 | Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”                              |  |  |  |
| 4 | Material i pisët                                                               |  |  |  |

**Shenim: ne fazen e ofertimit do te vleresohet plotesimi i tabelës sipas formatit.**

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke vlerësuar ndotjen dhe rrezikshmërinë që mbartin materialet spitalore, dhe rëndësinë e larges së këtyre materialeve me cilësi, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin ndaj pacientëve, operatori ekonomik duhet të garantojë se për shërbimin e lavanderisë do të përdorë produkte cilësore, me certifikatë konformiteti ose cilësi CE. Një garanci e tillë pëmbushet me paraqitjen e skedave teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, shërben si siguri për AK mbi aftësinë e OE për zbatimin e kontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion që i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

**Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbyshur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion të paktën një mjet, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e një mjeti lidhet ngushtësisht me procesin e transportimit të materialit të butë, nga lavanderia në ambientet e Spitalit dhe anasjelltas, pjesë e pandashme e realizimit të shërbimit të lavanderisë dhe përmbyshjes së kërkesave në kohë të AK. Kjo kërkesë është vlerësuar e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e procesit, garantuar funksionimin e pandërprerë të

shërbimit, mundëson organizim të marrjes së materialit të butë dhe shpërndarjes/dorëzimit të tij sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe termat e referencës.

2.3.9 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, dhe rrezikshmërinë që paraqesin materialet me ndotje spitalore, është e rëndësishme për AK të krijojë siguri që ofertuesi do të kryejë shërbimin e lavanderisë, duke garantuar shëndetin dhe sigurinë teknike në punë të punëmarrësve të angazhuar me kryerjen e këtij shërbimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj.**

**Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Spitali Korçë”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Tabelat dhe të gjitha të dhënat përkatëse të argumentuara sipas nevojave të Autoritetit përfitues janë pjesë e DST, në Specifikimet teknike dhe termat e referencës.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**